



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.170/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 03.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet ankesa e organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) - për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, sepse me dt. 29.09.2019, në tubimin zgjedhor të PDK-së, në Lipjan, fëmijët kanë mbajtur materiale promovuese të fushatës, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 2.800,00€, (dy mijë e tetëqind euro), të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Organizata BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP, me datë 01.10.2019, me të cilën pretendon se me dt.29.09.2019, në tubimin zgjedhor të PDK-së, në Lipjan, janë parë fëmijë duke mbajtur materiale promovuese të fushatës. Këto fotografi janë shfaqur në transmetimin e fushatës së PDK-së, në Lipjan, aty shihet një fëmijë nën moshën 15 vjeçare me kapelë, me mbishkrimin "PDK112", të subjektit politik PDK. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë subjekti politik PDK, ka shkelur Kodin e Mirësjelljes.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes, e subjektit politik PDK, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të datës 03.10.2019, theksoi se lidhur me ankesën Anr.170/2019, fotoja në fjalë është e paqartë nga ana e subjektit politik

(PDK), sepse fotoja në fjalë është e paqartë dhe nuk paraqet argumente se personat në fjalë janë të moshës së mitur.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre nuk i kanë bashkëngjitur asnjë provë si dëshmi.

Subjekti politik PDK, kërkon nga PZAP-i që ankesa e bërë ndaj tyre nga organizata BIRN dhe IKS, të hudhet e pabazë sepse fotografia nuk është e qartë dhe nuk paraqet argumente se personat që shihen në foto janë të moshës së mitur. Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, duke shikuar fotografinë e bashkëngjitur të tubimit zgjedhor, në të cilin fotografi në mënyrë të qartë shihet se personi është nën moshën 15 vjeçare dhe mbanë kapelë, me mbishkrimin "PDK112", andaj në mënyrë të padyshimtë, është vërtetuar se subjekti politik PDK, ka përdorur fëmijë në një tubim për fushatë zgjedhore, veprim ky që është në kundërshtim me zgjedhjet e nenin 2 pika 5.3 e Riformular pika b), c) dhe d), të Rregullës Zgjedhore nr.20/2019 mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores zgjedhore nr.13/2013 të KQZ-së, që në rastin konkret, një person nën 18 vjet bart material promovues në fushatë zgjedhore.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë, si dhe,
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik PDK, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t'u përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre, nuk e kanë pranuar shkeljen e supozuar, me arsyetimin e tyre se: në fotoja e bashkëngjitur nuk është e qartë dhe nuk paraqet argument se personat në fjalë janë të moshës së mitur.

PZAP mori parasysh pretendimet e tilla, pretendime të cilat nga ana e panelit janë të paqëndrueshme dhe subjekti politik PDK, nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për të

vërtetuar pretendimet e tyre, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Me këtë vendim dhe shqiptim të gjobës paneli vendosi se do të ndikon te subjekti politik që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 170/2019 më datën 03.10.2019**

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.